

AKT THEMELIMI
I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
“ALBSOLUTION“ shpk

Ne Tiranë, sot me datë 28 Janar 2019, në cilësinë e “ortaku themelues “:

ALBPASTRIM SHPK, me adresë Njësia Bashkiake nr.5, Rruga Komuna Parisit, Kompleksi Kika, Shkalla 6, kati 1, Zona Kadastrale 8260, Nr Pasurie 6/442+6-1, regjistruar në QKB 02/07/2015, me NIPT L51902007T

e cila në cilësinë e “ortakut themelues “, me vullnet të lire, të plote e të sinqerte, hartoi këtë akt themelimi për krijimin e shoqërisë përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “ALBSOLUTION“ shpk mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare “ të ndryshuar me ligjin 129/2014, në ligjin 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, në Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor.

KREU I

Neni 1

Krijimi

Shoqëria “ALBSOLUTION“ shpk, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria “ALBSOLUTION“ shpk, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga “ortaku e shoqërisë”, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaku gëzojnë kuotën e tyre në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që kanë dhënë në kapital.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë kryesore në Tiranë, në adresën : “adrese Njësia Bashkiake nr.5, Rruga Komuna Parisit, Kompleksi Kika, Shkalla 6, kati 1, Zona Kadastrale 8260, Nr Pasurie 6/442+6-1, Tiranë.



Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikës se Shqipërisë, vetëm me vendim te Ortakut te Shoqerise.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Kompania ka për objekt aktivitetet e mëposhtme, të cilat do të luajë të kufijve dhe në përputhje me dispozitat ligjore, të dy direkt dhe indirekt, duke përfshirë kontratat shoqatës pjesëmarrjes dhe marrëveshjeve ekskluzivitet, nëpërmjet filialeve, degëve dhe / ose filialeve :

Import – Eksport Tregtim materiale pastrimi, detergjente pastrimi artikuj te ndryshem industrial, produkte te linjes Horeca, produkte per ristorante dhe hotele.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1,000 lekë.

Kapitali i mesiperem eshte nënshkruar dhe do te shlyhet sapo te hapen llogarite bankare te shoqerise teresisht ne te holla nga "ortaku e shoqerise " i shoqerise :

ALBPASTRIM SHPK, eshte zoterues i 1 kuote me vlere 1000 leke, e cila perfaqeson 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaku pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe ne sherbime, nepermjet emerimit te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Asambleja e Ortakut në të njëjtat

kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të tij në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakut është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakut është organi vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Asambleja e Ortakut, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 10

Administrimi

Administratori i shoqërisë është z. Julian Begolli.

Administratori i shoqërisë do të ushtrojë kompetencat e administrimit për një afat 5 vjeçar me të drejte ripërteritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim të Asambleja e Ortakut të shoqërisë. Administratori i shoqërisë mund të emerohet edhe një person i tjetër jashtë ortakerisë.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem dhe të jashtëzakonshem të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga Asambleja e Ortakut;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Asambleja e Ortakut për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e Asambleja e Ortakut edhe në rastet kur : sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet

e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara, Administratori ka të drejte të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, Bankave të gjitha niveleve, zyrave të tatim taksave, autoriteteve doganore, përfshi këtu edhe autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12

Pergjegjesite

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Ortakut që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojë dhe mënjanë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
 - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
 3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Neni 13

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 14

Bilanci i shoqerise dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asambleja e Ortakut, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asambleja e Ortakut vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptare.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

Neni 16

Dispozita perfundimtare

Ky Akt themelimi i shoqerise "ALBSOLUTION" shpk, u redaktua me vullnetin te lire e te plote te "ortakut themelues", ne 3 ekzemplare me vlera te njejta juridike.

Julian Begalli

ORTAKU I SHOQERISE

Valbona Begalli

